

Iniciativa për dijalog strategjik
Grupi punues për të drejtat e njeriut
(Mars/Nëntor 2004)

Analiza e të drejtave të Njeriut dhe Rekomandime

Shkup, 2004

Hyrje.....	3
Nënshtetësia.....	5
Hyrje e shkurtër.....	5

Dispozita pozitive në Republikën e Maqedonisë.....	7
Konstatime lidhur me zbatimin e ligjit.....	8
Rekomandime.....	10
E drejta për liri të personalitetit.....	13
Probleme themelore.....	13
Rekomandime për Ministrinë e drejtësisë.....	16
Rekomandime për institucionet tjera.....	18
Të drejtat e njeriut dhe policia.....	18
Baza ligjore.....	19
Disharmoni midis të përshkruarës dhe zbatimit.....	21
Përgjegjësia dhe kontrolli i policisë.....	23
Rekomandime.....	26
Gjyqësia dhe të drejtat e njeriut.....	29
Dobësitë e sistemit gjyqësor.....	29
Reforma në Legjislativën procesuale.....	31
Rekomandime për reforma në legjislativën procesuale.....	31
Vështrim i aplikimit të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut nga gjyqet vendase në veprimin e tyre.....	32
Rekomandime për implementimin e Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNj).....	33
Rekomandime për reformë strukturore dhe organizative.....	37
Komente plotësuese.....	38
Anëtarë të grupit punues për të drejtat e njeriut.....	41

Hyrje

Iniciativa për dijalog strategjik është projekt i Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve (QEÇM) të zyrës rajonale në Shkup. Në kuadër të këtij projekti u themeluan katër grupe punuese që diskutuan për probleme që kanë të bëjnë me arsimin, ekonominë, shëndetësinë dhe të drejtat e njeriut. Anëtarët e grupit punues janë përfaqësues nga institucione me ndikësë për çdonjërën nga lëmitë. Qëllimi parësor i këtyre grupeve punuese është që ti identifikojnë problemet dhe të përpilojnë rekomandime që do tu ndihmojnë atyre që sjellin vendime, të formulojnë dhe implementojnë politikë të drejtë dhe gjithpërfshirëse e cila do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve, do ta forcojë mbisundimin e të drejtës dhe do të mundësojë kushte më të mira ekonomike për të gjithë popujt që jetojnë në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi sekondar është përforcimi dhe vendosja e marrëdhënieve punuese midis pjesëtarëve të segmenteve të ndryshme të shoqërisë.

Çdonjëri nga grupet punuese numëron prej 10 deri 15 ekspertë nga tre profilë të ndryshëm profesional: politikanë dhe anëtarë të qeverisë, profesorë univerzitar, profesionistë dhe ekspertë të lëmive relevante si dhe liderë dhe aktivistë të Organizatave joqeveritare (OJQ-ve). Anëtarët e grupeve punuese u takojnë të gjitha grupeve etnike dhe fetare në Maqedoni dhe shumica e tyre janë nga Shkupi, ndërsa anëtarët tjerë vijnë nga Tetova, Gostivari, Manatiri, Shtipi dhe Kumanova.

Çdonjëri nga grupet punuese takohet çdo javë të tretë ose të katërt të muajit dhe puna e tyre zhvillohet përmes një vargu hapash të planifikuara për identifikimin, definimin dhe dhënien përparësi të lëmive kryesore që shkaktojnë probleme, e të cilat janë në kuadër të punës së tyre, grumbullimit të informacioneve plotësuese për problemet prioritare, analizës së informacioneve, përgatitjes së rekomandimeve dhe zhvillimit të strategjisë për prezentimin e të njejtave.

Kah fundi i vitit, çdo grup punues do të mbajë konferencë për mediat, në të cilën do të prezentojë rezultatet dhe rekomandimet që kanë të bëjnë me problemet.

Menjëherë pas kësaj do të organizohen takime bilaterale midis përfaqësuesve të grupeve punuese dhe personaliteteve relevante të institucioneve dhe organizatave që janë emërtuar në rekomandimet.

Me planifikimin e kohës për punë me institucionet dhe organizatat që kanë mandat për implementimin e reformave do ta shtojmë probabilitetin që rekomdimet të kuptohen dhe të përkrahen.

Grupi punues për të drejtat e njeriut analizoi katër tema në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë. Dy tema ishin të fokusuara mbi çështjet që kanë të bëjnë me Nënshitetësinë dhe të drejtën e lirisë, dy tema ishin të fokusuara në rolin e institucioneve shtetërore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (Ministria e punëve të brendshme dhe Ministria e drejtësisë).

Ne organizuam takime bilaterale me Ministrinë e punëve të brendshme, me Ministrinë e drejtësisë, Gjykatën kushtetuese dhe me disa organizata ndërkombëtare.

Nëse dëshironi të keni më tepër informacione për organizatën tonë si dhe për projektet që i realizojmë, Ju ftojme që ta vizitoni faqen tonë të internetit www.ecmipolicydialogue.org.mk ose www.ecmimacedonia.org.mk ose të na kontaktoni çdo ditë pune prej orës 09:00-17:00.

Me shpresë se do të kemi bashkëpunim në të ardhmen,

Michael Szporluk
Këshilltar politik

Nënshtetësia

Hyrje e shkurtër

Çështja e nënshtetësisë u paraqit me tërë peshën e saj pas shpërbërjes së Jugosllavisë (RSFJ-së) në vitin 1991 dhe me paraqitjen e pesë shteteve trashigimtare. Në Republikën e atëhershme Socialiste të Maqedonisë u gjend një numër i madh i shtetasve të ish shtetit të përbashkët të cilët në baza të ndryshme jetonin këtu (në sajë të martesës, punësimit ose lindjes në teritorin e saj). Këto shtetas të mëparshëm jugosllav u takonin bashkësive joshumicë, posaçërisht të shqiptarëve etnik, Romëve, por edhe serbëve (në disa mjedisë rurale). Problemi me nënshtetësinë të parregulluar prek poashtu edhe fëmijët e lindur në teritorin e Maqedonisë nga prindër me status të parregulluar të shtetësisë, për shkak se shtetësia fitohet në pajtim me *jus sanguinis* e jo *jus soli*. Personat me status të parregulluar të shtetësisë egzistojnë *de facto*, dhe *de jure* egzistojnë dhe si pasojë të kësaj kanë qasje të kufizuar ndaj të drejtave qytetare, politike dhe sociale.

Nëse çështja e nënshtetësisë shihet nga një dimenzion historik, mund të konstatohet se deri para shpërbërjes së jugosllavisë së mëparshme (RSFJ-së) të gjithë qytetarët kishin nështetësi të RSFJ-së, si dhe nënshtetësi të brendshme të republikave të njëjës nga gjashtë republikat socialiste, që ishte e evidentuar në Librat republikanë të shtetasve, që ekzistonin dhe mbaheshin në nivel të komunave. Në jetën praktike shtetësia republikane nuk kishte ndonjë rëndësi dhe ndikesë të veçantë. Mirëpo, pas sukcesionit të shtetit

çdonjëri nga shtetet trashigimtare gjatë përcaktimit të statusit të shtetësisë të qytetarëve vijuan parimin e kontinuitetit juridik të shtetësisë së mëparshme

republikane. Kështu, një numër i caktuar personash u gjendën në situatë të mos jenë të kyçur në korpusin e shtetasve të vendit ku faktikisht kanë qëndruar, ku janë të lindur ose në të cilin kanë lidhje familiare ose të tjera faktike, e në vend të kësaj u bënë shtetas të vendit me të cilin nuk kishin kurrfarë lidhshmërie efektive.

Dispozita pozitive në Republikën e Maqedonisë

Në Republikën e Maqedonisë lënda e shtetësisë kryesisht është e rregulluar me :

- Ligjin për nënshtetësinë të Republikës së Maqedonisë të vitit 1992
- Konventën Evropiane për nënshtetësinë të vitit 1997 të ratifikuar në Janar të vitit 2002
- Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për nënshtetësinë të Republikës së Maqedonisë i muajit Shkurt të vitit 2004.

Ligji për nënshtetësinë e Republikës së Maqedonisë i vitit 1992 me dispozitën kalimtare në nenin 26 lë hapësirë prej një viti që shtetasit e republikave tjera të RSFJ-së së mëparshme të mund të fitojnë shtetësinë e Republikës së maqedonisë me rrethana lehtësuese. Mirëpo, edhe për shkak të mosdijes, edhe për shkak të fushatës së dobët

informative, pas skadimit të afatit prej një viti, shtetasit e ish republikave jugosllave që kanë qëndruar në Maqedoni dhe të cilat kanë pasur lidhmëri të vërtetë dhe efektive, u shëndruan në qytetarë të huaj. Për qëndrimin e tyre të mëtejshëm ligjor në Republikën e Maqedonisë duhej të aplikoheshin dispozitat e Ligjit për lëvizje dhe qëndrim të të huajve (i vitit 1992), që do të thotë të paraqesin kërkesë për qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm dhe të zëvendësojnë letrat e vjetra të njoftimit me letra njoftimi për të huaj. Informimi jo i mjaftueshëm i qytetarëve, kultura e ulët administrative dhe mundësitë e dobëta financiare të grupeve të caktuara etnike, e posaçërisht tek Romët, krijuan situatën në të cilën një numër i madh i personave vazhduan të jetojnë në Maqedoni pa qëndrim ligjor.

Marrja e nënshtetësisë së Republikës së Maqedonisë përmes lindjes, në pajtim me nenet 7 dhe 9 të Ligjit në praktikë shkaktoi shumë vështirësi dhe probleme. Faktorë më të rëndësishëm që i vështirësojnë procedurat ishin: mospasja e letrës së njoftimit për të huaj ose letër njoftimi që i ka kaluar afati, mospasja e dëshmisë për qëndrim të pandërprerë

ligjor prej më së paku 15 vjet, mospasja e dëshmisë relevante për banesë të siguruar dhe burim të përhershëm të mjeteve, martesë të paregjistruara, probleme

me sigurimin e çertifikatës së lindjes nga librat e amzës të të lindurve në republikat tjera të mëparshme të RSFJ-së, taksa e lartë administrative e tjera.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të shtetësisë i Republikës së Maqedonisë i muajit Shkurt të vitit 2004 është një hap i madh përpara në përpjekjet për lehtësimin e procedurave që banorët shumëvjeçarë të rëndomtë të marin shtetësinë e Republikës së Maqedonisë. Në nenin 14 është paraparë që shtetasit e republikave tjera të RSFJ-së së mëparshme, të cilët më 8 Shtator të vitit 1991 kanë pasur të paraqitur vendbanimin, deri në paraqitjen e kërkesës jetojnë vazhdimisht në teritorin e Reëublikës së maqedonisë dhe kanë lidhje efektive me RM-në, mund të fitojnë nënshtetësinë e RM-së nëse në afat prej dy vite pas hyrjes në fuqi të ligjit parashatrojnë kërkesë, nëse kundër tyre nuk zhvillohet procedurë penale për vepra penale me të cilat rrezikohet siguria dhe mbrojtja e Republikës së Maqedonisë dhe nëse janë me moshë madhore dhe nëse zotërojnë gjuhën maqedonase deri në shkallë që të mund lehtë të merren vesh me rrethinën.

Konstatime që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit

- Zbatimi gjashtëmujor i Ligjit tregoi se në njësitë e ndryshme rajonale të Ministrisë së punëve të brendshme në mënyrë të ndryshme spjegohet neni 14, posaçërisht në lidhje me ate se cilat dokumenta-dëshmi duhet të sigurohen si shtesë bashkë me Kërkesën për pranim në nënshtetësi të Republikës së maqedonisë. Në mënyrë të caktuar kjo është zbutur me telegramin me instruksione (me karakter intern) të Ministrisë së punëve të brendshme që u është dërguar të gjitha njësive rajonale. Por, edhe udhëzimi për aplikimin e nenit 14 të Ligjit i shkruar në telegramin, në njësi të ndryshme rajonale spjegohet në mënyra të ndryshme.

Për shembull, nga pala kërkohet të sigurojë dëshmi për vendbanim të paraqitur më 8 Shtator të vitit 1991, edhe pse në telegramin e përmendur

shkruan se këtë fakt, nga evidenca, *ex officio*, do ta përcaktojë Ministria e punëve të brendshme. Mandej, MPB-ja, faktin nëse personi ka pasur të paraqitur vendbanim të paraqitur më 8 Shtator të vitit 1991 e përcakton me dëshminë nëse personi në këtë datë kritike ka pasur letër njoftimi valid të Republikës Socialiste të Maqedonisë dhe të RSFJ-së. Çka nëse vlefshmëria e letër njoftimit ka skaduar para 8 Shtatorit të vitit 1991? A do të thotë kjo se personi nuk ka pasur vendbanim të paraqitur në datën kritike?

Tek kushti qëndrim i pandërprerë në teritorin e RM-së dhe lidhja e vërtetë dhe efektive me RM-në mjafton prezantimi edhe vetëm të një dëshmie valide (për shembull – librezat shëndetsore ose librezat e punëtorit ose vërtetim për marrëdhënie të punës e ngjashëm). Në rast të këtillë nuk ka nevojë që nga pala të kërkohen edhe dëshmi tjera, si për shembull, dëshmi pronësie, letër njoftimi valid për të huaj e tjera.

- Në disa njësi rajonale të MPB ekziston paqartësia rreth çështjes për lirimin e palës nga obligimi për pagesën e taksës administrative në lartësi prej 20 EURO për dhënie e kërkesës dhe 80 EURO për marrjen e vendimit për pranim në shtetësinë e RM-së. Kjo çështje është e rregulluar me nenin 15, pika 19 e Ligjit për taksat administrative, të muajit Mars të vitit 1993.

- Ministri i punëve të brendshme ende nuk i ka sjellë dispozitat nënligjore edhe pse ka kaluar afati gjashtëmuor i paraparë me nenin 27 të këtij ligji.

- Në nenin 15 të Ligjit autorizohet komisioni Ligjdhënës-juridik i Kuvëndit të RM-së të përcaktojë tekst të pastruar të Ligjit për nënshtetësi të Republikës së Maqedonisë. Teksti i pastër i Ligjit për nënshtetësinë e Republikës së Maqedonisë është botuar në Gazetën zyrtare të RM-së numër 45, të 7 Korrikut të vitit 2004. Kaptina për dispozitat kalimtare tërësisht është e gabuar dhe nevojitet rregullimi i saj. Mbetet e paqartë nëse është bërë gabim në procedurën e miratimit të Ligjit në Kuvëndin e Republikës së Maqedonisë, gabim në shtypjen e tekstit të ligjit ose bëhet fjalë për gabim të komisionit Ligjdhënës-juridik.

- Pa marrë parasysh se kanë kaluar pothuajse nëntë muajë nga miratimi i Ligjit, nuk realizohet kurrfarë fushate informative, kështu që ekziston

mundësia që edhe kësaj radhe një numër i madh njerëzish (njëlloj si në vitin 1992) të lëshojnë gjasën për marrjen e nënshtetësisë së Maqedonisë me kushte lehtësuese.

REKOMANDIME

- Ministria e punëve të brendshme të sjell akt nënligjor (Udhëzim). Me botimin e tij në Gazetën zyrtare të RM-së do të sigurohet qasje e barabartë ndaj informacioneve, si për të punësuarit në MPB, ashtu edhe për subjektet tjera që shfaqin interesim për këto.
- Ministria e punëve të brendshme, e posaçërisht njësitë rajonale të MPB-së, në mënyrë të përpiktë e respektojnë dispozitën e nenit 15, pika 19 të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e RM-së nr.17 e 26 Marsit të vitit 1993) për lirim nga obligimi për pagesë të taksave administrative nga ana e qytetarëve me gjendje të vështirë financiare, nga ana e shfrytëzuesve të të drejtave themelore dhe tjera të parapara me Ligjin për mbrojtje sociale.
- Komisioni Ligjdhënës-juridik i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë bëri dhe botoi përmirësimin e tekstit të Ripastruar të Ligjit për shtetësinë e Republikës së Maqedonisë (Gazeta zyrtare e RM-së nr.45 e 7 korrikut të vitit 2004)
- Ministria e punëve të brendshme të ketë raport më fleksibil në procedurat për marrjen e nënshtetësisë së RM-së për banorët afatgjatë të rëndomtë që aplikojnë për nënshtetësinë në pajtim me nenin 14 të Ligjit.

Duke pasur parasysh faktin që kushti, zotimin e gjuhës maqedonase deri në shkallë që të mund të kuptohet me rrethin e përcakton komisioni i posaçëm pranë Qeverisë, rekomandohet që Komisioni të ketë raport më fleksibil, posaçërisht ndaj personave më të moshuar se 60 vjet

- Ministria e punëve të brendshme ta shkurtojë kohëzgjatjen e procedurave për marrjen e nënshtetësisë së RM-së, posaçërisht pjesën e procedurës që është nën kompetencën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim.
- Të organizohet fushatë më e mirë informative përmes:
 - Mediat e shtypura dhe elektronike;
 - Organizimit të tryezave të rrumbullakëta dhe konferencave me përfaqësues të pushtetit shtetëror, deputetë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, gazetarë, organizata joqeveritare dhe aktivistë për të drejtat e njeriut e tjerë.

Bartës të fushatës informative të jenë: Ministria e punëve të brendshme, Misionet e organizatave ndërkombëtare në RM, organet e pushtetit vendor dhe mediat.

Me projekte të tyre, vend të posaçëm në fushatën informative të marrin edhe organizatat joqeveritare. Në përpjekjet për transmetimin e informacioneve deri te çdo qytetar si në mjediset urbane ashtu edhe në mjediset rurale nevojitet një mobilizim i plotë i ekipeve të tyre profesionale dhe anëtarësisë (shpërndarja e broshurave dhe pamfleteve informative, vizita e tyre prej dera në derë e ngjashëm).

Në mungesë të një fushate të këtillë të menduar dhe të menduar mirë, ekziston mundësi që edhe kësaj radhe, njëlloj si në vitin 1992/93, të lëshojnë gjasën për

marrjen e nënshtetësisë së Republikës së Maqedonisë me kushte lehtësuese. Neni 14 i Ligjit ofron gjasë historike që banorët shumëvjeçar të rëndomtë më në fund ta

zgjidhin statusin e tyre në Republikën e Maqedonisë, në të cilën *de facto* jetojnë dhe punojnë, ndërsa *de jure* janë shtetas të saj.

E drejta e lirisë së personalitetit

E drejta e lirisë së personalitetit është e garantuar me kushtetutë [neni 12 dhe neni 13 (2) i Kushtetutës] , dhe e njejta është e mbrojtur edhe me nenin 5 të konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave njerëzore (e njohur si Konventa Evropiane për të drejtat e njerit, KEDNJ)

Gjykatat, MPB, Ministria e drejtësisë, Gjykata kushtetuese, janë faktorët kryesorë për respektimin, por edhe për shkeljen e kësaj të drejte individuale njerëzore.

Probleme themelore

1. Ekzistojnë shumë paqartësi lidhur me atë se çka paraqet kufizimi i lirisë së personalitetit, gjë e cila është e komplikuar në mënyrë plotësuese edhe me përdorimin konfuz të termeve *thirrje, marje, arrestim, privim nga liria, paraburgim...*
2. Edhe pse e drejta për liri është e formuluar pozitivisht në Kushtetutë, e njejta nuk është e afirmuar pozitivisht në ligjet, gjë e cila përforcon paragjykimin se policia “ka të drejtë”-pa vendim gjyqësor-të thërrasë, të merr, ose të privojë nga liria një person, dhe të njejtin ta mbajë aty 24 orë.
3. Ekziston paragjykimi, i bazuar në praktikën e gabueshme, se policia është ajo që vendos për privimin nga liria e jo gjykata. Edhe pse sipas nenit 12, alineja 2 e Kushtetutës, “askujt nuk mund ti kufizohet liria, **përveçse me vendimin e gjykatës** edhe në raste dhe në procedurë të përcaktuar me ligj”, neni 188 i Ligjit për procedurë penale u mundëson personave të autorizuar zyrtar (PAZ) pa vendim të gjykatës ta privojnë nga liria dhe personin për të cilin ekzistojnë baza për dyshim se ka kryer vepër penale për të cilën ai ndiqet sipas detyrës zyrtare nëse ekziston rreziku nga shtyerja, dhe ekziston ndonjëri prej shkaqeve për paraburgim (nga neni 184, alineja 1 e Kodit për

procedurë penale-KPP)-por janë të obliguar menjëherë ta sjellin para gjykatësit të autorizuar hetues.

4. Neni 188, alineja 3 nga KPP madje u mundëson PAZ, me përjashtim ta mbajnë personin të privuar nga liria. Mbajtja mund të zgjasë më së shumti 24 orë. Pas skadimit të këtij afati, personio i autorizuar zyrtar i Ministrisë së punëve të brendshme është i obliguar që personin e mbajtur në polici ta lëshojë në liri ose ta sjell para gjykatësit të autorizuar hetues. (Sipas nenit 188, alineja 6 të KPP). Domethënë, ekziston dispozitë ligjore e cila u mundëson personave të autorizuar zyrtarë të privojnë nga liria një person ta mbajnë më së shumti 24 orë duke mos e nxjerë personin e privuar nga liria para gjykatës. Mundësia e këtillë nuk përputhet me dispozitën kushtetuese se “personi i privuar nga liria duhet doemos menjëherë e më së voni në afat prej 24 orësh nga momenti i privimit nga liria, të sjellet përa gjykatës, e cila pa shtyerje do të vendosë për ligjshmërinë e privimit nga liria”.
5. Madje edhe në rastet kur personat e privuar nga liria do të sjellen para gjykatës, gjykata shumë shpesh dështon si garantues i të drejtës së lirisë personale dhe nuk e heton ligjshmërinë e privimit nga liria. Në raste të shumta, gjykata nuk kërkon që të prezentohen shkaqe të qarta e as nuk ua nënshtron kontrollit, duke e përkrahur në këtë mënyrë sjelljen arbitrare të policisë. Gjykatat më së shpeshti e konfirmojnë vendimin e autoriteteve policore, dhe nuk sjellin aktvendim të pavarur kritik.
6. Ekziston një praktikë e gabueshme që gjykatësit të shqiptojnë paraburgim me afat maksimal (30 ditë) dhe ta vazhdojnë paraburgimin duke mos i hulumtuar sërish shkaqet për shqiptimin e masës. Arsyetimet gjyqësore në vendimet për vazhdimin e paraburgimit më së shpeshti, fjalë për fjalë, janë identike me vendimin e parë, që tregon se vazhdimi i paraburgimit bëhet në sajë të automatizmit.
7. Mosazhurniteti i procedurave për përcaktimin e ligjshmërisë së paraburgimit është vetëm një nga faktorët që e pamundësojnë realizimin e

- të drejtës të zhdëmtimit të dëmit të garantuar në nenin 13,alineja 2 e Kushtetutës.
8. Privimi nga liria, fjalë të cilit injorohen të drejtat e personave që janë privuar nga liria, shpeshherë është e përcjellur me poshtërim jonjerëzor dhe përpjekje që me dhunë të pranohet faji.
 9. Mungesa e evidencës së detajuar për vendin, kohën dhe lokacionin e paraburgimit, emrin e të paraburgosurit si dhe shkaqet për paraburgimin, gjë e cila është jokompatibile me nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
 10. Dështimi i kontrollit të brendshëm të policisë në raste kur kemi indicie për privim të paligjshëm nga liria si dhe indicie për trajtim jonjerëzor kundër personave të privuar nga liria.
 11. Pasiviteti i prokurorisë në raste kur ka (dhe pasivitet edhe më i madh kur nuk ka) ankesa për lëndimet e bëra gjatë arrestimit, mbajtjes në polici, paraburgimit ose gjatë kryerjes së dënimit në Entin ndëshkues, me ç'rast më së shpeshti mungon ndërmarja e veprimeve përkatëse hetuese.
 12. Mosdëgjimi nga ana e gjykatësit të deklaratave për abuzime nga ana e policisë në rastet kur personi i privuar nga liria do të del para gjykatës, dhe mosndërmarrje e masave përkatëse, madje edhe në rastet kur tek personat e sjellur para gjykatësit lëndimet e jashtme janë të dukshme.
 13. Mosrespektimi i të drejtës për të thirrur mjekun sipas zgjedhjes vetanake të personit të privuar nga liria; mungesa e të dhënave të detajuara medicinale për gjendjen shëndetsore të personave të privuar nga liria (në të cilat do të përfshihen edhe pohimet eventuale për keqtrajtim nga ana e policisë, mandej mendimi mjeksor për konzistencën e pohimeve të pesonit të privuar nga liria dhe rezultatet objektive medicinale); kujdesi jopërkatës mjeksor

ndaj personave të privuar nga liria, gjë e cila në raste të caktuara rezulton edhe me vdekje.

Rekomandime për Ministrinë e drejtësisë

- 1) Përgatitja e propozim ndryshimeve të rregullativës ligjore dhe nënligjore me qëllim që:
 1. Juridikisht të afirmohet koncepti i presumpcionit (supozimit) në favor të lirisë;
 2. Të definohet qartë qëllimi i privimit ligjor nga liria-sjellja e personit para autoritetit kompetent gjyqsor;
 3. Të sqarohet konfuzioni terminologjik dhe legjislativa vendore të harmonizohet me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Njerëzore, në të cilën termet *arestim* dhe *detencion* përdoren si sinonimë;
 4. Të zgjerohet koncepti ekzistues vendor juridik i privimit nga liria (i cili sipas ndryshimeve më të reja në KPP, nuk përfshin marjen me dhunë) që ti përfshijë të gjitha format e privimit nga liria që ekzistojnë në Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, duke marrë parasysh pamundësinë që të shkohet me vullnetin e vet si njëri nga faktorët kyç;
 5. Të ndryshojnë dispozitat ligjore në sajë të të cilave legjitimohet praktika policore e privimit arbitrar nga liria pa vendim gjyqsor (në sajë të “thirrjes” dhe “mbajtjes” deri 24 orë) pa sjelljen para organit kompetent gjyqsor;
 6. Të zbatohen masa plotsuese mbrojtëse të cilat do të sigurojnë njohjen e papenguar dhe gëzimin e të drejtave njerëzore nga ana e njeriut të privuar nga

liria, e posaçërisht sa i përket të drejtës për të pasur avokat (duke përfshirë aty edhe komunikimin e lirë me të në gjuhën amëtare), si dhe të drejtën për mjek sipas zgjedhjes vetanake dhe mbrojtjes përkatëse shëndetësore.

7. Të sigurohet mbajtja e evidencës së detajuar gjatë privimit nga liria, për shkaqet e privimit nga liria, për vendin, kohën dhe lokacionin e paraburgimit, emrin e të paraburgosurit, të dhënat e detajuara medicinale për gjendjen shëndetësore, si dhe të dhënat tjera relevante.

2) Organizimi i stërvitjeve për gjykatësit (si persona më përgjegjës në drejtim të mbrojtjes së të drejtës të individit që të mos jetë i privuar nga liria në mënyrë arbitrare), me vështrim të posaçëm mbi:

1. Të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së personit në sistemin e mbrojtjes së Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut;
2. Përgjegjësinë e gjykatësit gjatë përcaktimit të ligjshmërisë të privimit nga liria; gjatë përcaktimit të bazueshmërisë të shkaqeve për paraburgim; gjatë përcaktimit të faktit nëse të njëjtat shkaqe vazhdojnë të ekzistojnë kur kemi kërkesë për vazhdimin e paraburgimit;
3. Nevojën për intervenim urgjent gjyqësor për të penguar tortura ose trajtimi jonjerëzor nga ana e policisë, ose për të përcaktuar çfarëdoqoftë paligjshmëri gjatë privimit nga liria në rastet kur ekzistojnë indicie për këtë;
4. Përgjegjësinë e gjykatësit në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore, që nënkupton edhe mbikqyrje përkatëse të rregullt gjyqësore mbi personat që janë privuar nga liria;
5. Përgjegjësinë e gjykatësit si në pikëpamje të mbrojtjes së të drejtës së presumpcionit të pafajsisë, ashtu edhe në pikëpamje të mbrojtjes së privatësisë së personave të privuar nga liria.

Rekomandime për institucionet tjera

- 1) Organizimi i stërvitjeve për prokurorët lidhur me të drejtën për liri dhe siguri të personalitetit në sistemin e mbrojtjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, si dhe për të drejtat tjera të garantuara të personave të privuar nga liria (me vështrim të posaçëm mbi mbrojtjen e të drejtës së ndalesës së torturës, trajtimit jonjerëzor dhe poshtëruës);
- 2) Organizimi i seminareve për mediat, në të cilat do të afirmohet koncepti i presumpcionit në favor të lirisë, do të promovohet e drejta e presumpcionit të pafajsisë dhe e drejta e privatësisë së personave të privuara nga liria
- 3) Krijimi i komisionit të pavarur të ekspertëve në të cilin poashtu do të jenë anëtarë edhe ekspertë nga shoqatat e qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, komision ky i cili sëpaku një herë në vit do të bëjë *ad hoc* vizita të të gjitha institucioneve të burgosjes për të cilat ka indicie se aty ndodhin shkelje të të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria.

Të drejtat e njeriut dhe policia

Të drejtat e njeriut rrjedhin nga dinjiteti i personalitetit të njeriut, nga vetë qenia e njeriut. Në funksion të nxitjes, respektimit dhe përparimit të të drejtave të njeriut, Bashkësia ndërkombëtare gjithmonë është në “kërkim” për gjetjen e standardeve të reja, më të avancuara univverzale që do të mishërohen në ligjet nacionale të të gjitha shoqërive demokratike.

Asnjë institucion tjetër në shoqëri nuk ndikon mbi gjendjet e mosrespektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, siç ndikon policia për shkak se ajo vepron edhe përmes formave të përdorimit ligjor të forcës. Prandaj në shoqëritë ku të drejtat e njeriut shkelen nga policia këto shkelje identifikohen si shkelje nga ana e shtetit, përkatësisht si dettyrim i dhunshëm shtetëror. Puna dhe sjellja e policisë depërton dhe ndikon drejtpërdrejtë mbi integritetin fizik dhe psikik të njeriut. Prandaj, sjellja e policisë ndaj të drejtave të drejtave të njeriut dhe në përgjithësi ndaj qytetarëve vazhdimisht gjendet nën monitoringun e institucioneve dhe organizatave të ndryshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Pas shpërbërjes së regjimit komunist në shtetet e Evropës Juglindore, e poashtu edhe në Republikën e Maqedonisë, të drejtat e njeriut fituan kuptimin e ri, frymën dhe koncepcionin e ri. Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar të gjitha deklaratat dhe konventat ndërkombëtare që trajtojnë çështje nga lëmia e të drejtave dhe lirive njerëzore, midis të cilave edhe **Konventën për Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut** (e njohur si Konventa Evropiane mbi të drejtat e njeriut) dhe **Konventa prevencës së torturës dhe sjelljes dhe ndëshkimit jonjerëzor**. Këto konventa tanimë janë pjesë e sistemit ligjor të Republikës së Maqedonisë.

Baza Ligjore

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë i korporuar dhe vazhdimisht po inkorporohen në legjislativën e Republikës së Maqedonisë.

Me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë të vitit 1991, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit, të pranuar në të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë bëhen vlera themelore të rendit kushtetues (neni 8, paragrafi 1 i Kushtetutës). Sipas nenit 11 të Kushtetutës, integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacenueshëm.

Ndalohet çdo formë e torturimit, sjelljes dhe ndëshkimit jonjerëzor ose poshtërues.

Sipas nenit 12 të Kushtetutës:

“E drejta e njeriut për liri është e patjetërsueshme. Liria e asnjë personi nuk mund të kufizohet, përveç se me vendimin e gjyqit ose në rastet dhe procedurat e përcaktuara me ligj. Personi i thirur, i ndaluar dhe i privuar nga liria duhet që doemos menjëherë të informohet për shkaqet e thirjes së tij ose kapjes, apo privimit nga liria. Ata nuk mund të detyrohen që të japin deklaratë. Çdo person ka të drejtë të ketë avokat gjatë procedurave policore dhe gjyqsore. Personat e privuar nga liria duhet të nxjerret para gjykatës sa më shpejtë që është e mundshme, madje, brenda periudhës maksimale prej 24 orësh nga momenti i privimit nga liria, ai duhet të del para gjykatës e cila, pa prolongim duhet të vendos për ligjshmërinë e paraburgimit të tyre”.

Ingerencat dhe autorizimet e policisë, përveç që janë të determinuara me **Kushtetutën**, ato janë të përcaktuara edhe në **Ligjin për procedurë penale, Ligjin për punët e brendshme** dhe në aktet nënligjore të sjellura nga MPB siç janë **Rregullorja për kryerjen e punëve në Ministrinë e punëve të brendshme, Rregullorja përkryerjen e punëve në sektorin të kontrollit të brendshëm dhe standardet profesionale të Ministrisë të punëve të brendshme, Rregullores për përdorimin e mjeteve të dhunës dhe të armëve të zjarrit** dhe një akt tejet i rëndësishëm **Kodeksi i Etikës policore** si dhe akte tjera nënligjore.

Përmbajtja e **nenit 12 të Kushtetutës** është inkorporuar në **Nenin 3 të ligjit për procedurë penale** dhe në **Nenet 53, 54, 55, dhe 56 të Kodeksit për Etikën policore**.

Në nenin 4 të **Rregullores për kryerjen e detyrave nga ana e Ministrisë së punëve të brendshme** theksohet se në kryerjen e punëve të Ministrisë, personat e autorizuar zyrtar mbrojnë dhe ruajnë jetën dhe pronën e qytetarëve, respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut dhe në mënyrë të përshkruar aplikojnë mjetet e përcaktuara me **Ligjin ose dispozitë tjetër të sjellur në sajë të Ligjit**. Në nenin 6 të të njejtës **Rregullore** theksohet se personat e autorizuar zyrtare në kontaktet me qytetarët drejtohen në mënyrë të sjellshme dhe zyrtare, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme e kumtojnë shkakun për të cilin u drejtohen ose ndërmarin shkakun për të cilin u drejtohen ose ndërmarin ndonjë mase tjetër të caktuar, i njohin me të

me të drejtat dhe obligimet e qytetarëve, legjitimohen nëse janë në veshje civile, ndërsa, nëse punët i kryejnë me uniformë, këtë e bëjnë me kërkesën e qytetarit. Legjitimimi i personave të autorizuar zyrtare bëhet përmes shfaqjes së legjitimacionit zyrtar, në mënyrë që qytetari të mund ta lexojë tekstin dhe ta shohë fotografinë, ndërsa emrin e tij personal dhe njësinë organizative, personi i autorizuar zyrtar e kumton gojarisht poqese qytetari e kërkon këtë.

Nene me përmbajtje të njejtë parasheh edhe **Kodeksi i Etikës policore**. Në **Nenin 2, paragrafi 1, alineja 1 e këtij Kodeksi** si qëllim themelor i policisë radhitet edhe mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut të garantuara me Kushtetutën si dhe të drejtat që garantojnë me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut. Ndërkaq, **Neni 46** parasheh se gjatë procedimit, pjesëtarët e policisë gjithmonë legjitimohen, si dëshmi për statusin e tyre policor dhe identitetin profesional.

Disharmoni midis së përshkruarës dhe zbatimit

Nga leximi i dispozitave të theksuara më lartë, përkatësisht nga leximi i dispozitave të cilat e rregullojnë punën e policisë fitohet përshtypja se bëhet fjalë për një polici e cila është sendërtuar mbi parimet e respektimit të të drejtave të njeriut.

Përkundër këtyre standardeve të njohura dhe të përkrahura, raportet e institucioneve për mbrojtjen e të drejtave njerëzore, të dhënat nga terreni dhe ankesat nga qytetarët tregojnë se në Republikën e Maqedonisë të drejtat dhe liritë e njeriut në mënyrë më serioze dhe më flagrante shkelen nga policia, përkatësisht nga përfaqësuesit e Ministrisë e punëve të brendshme.

Shikuar në përgjithësi, **Policia** gjatë kryerjes së punëve që kanë të bëjnë me qytetarët **më shpesh dhe më shumë shkel Nenet 11 dhe 12 të Kushtetutës dhe**

dispozitat tjera që janë të mishëruara në frymën e këtyre neneve. (Përmbajtja e këtyre dispozitave tanimë është theksuar në fund të faqes 1 dhe në fillim të faqes 2).

Shkelja e Neneve 11 dhe 12 të Kushtetutës është konstatuar edhe gjatë realizimit të aksioneve më të mëdha të policisë edhe gjatë veprimeve të zakonshme. Në operacionet e mëdha policore që u realizuan në **Haraçinë** (në Janar të vitit 2000), **Tearcë** (në Shkurt të vitit 2001), **Sopot** (në Maj të vitit 2003), **Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë pas daljes në vendin e ngjarjes dhe pas grumbullimit të fakteve ka konstatuar shkelje serioze të të drejtave njerëzore të banorëve të këtyre vendbanimeve që ishin subjekt i trajtimit policor, përkatësisht ka konstatuar tejkalime serioze të autorizimeve nga ana e policisë.**

Në këto aksione, para së gjithash u shkel parimi i pacenueshmërisë së shtëpisë, parimi i pacenueshmërisë së integritetit të njeriut dhe sjellja jonjerëzore, dhe parimi i presumpcionit të pafajsisë-supozimit të pafajsisë, e tj.

Gjatë këtyre aksioneve policia nuk ka treguar urdhëresë gjyqësore për bastisje, fizikisht dhe psikikisht ka maltretuar qytetarët, ka ushtruar dhunë joadekuate, nuk ka njoftuar qytetarët me të drejtat e tyre sipas Nenit 12 të Kushtetutës, e posaçërisht ka tejkaluar limitin e mbajtjes në paraburgim policor prej 24 orë. Gjatë marrjes në automjetet policore, personave të paraburgosur u janë vendosur trasta të zeza plastmasi në kokë, që të mos mund ti bien në fije se në çfarë drejtimi i çojnë. Disa nga personat e paraburgosur që poashtu kanë pasur sy të mbyllur ose trastë në kokë kanë qenë të lidhur për kaloriferët (radijatorët), dhe në atë gjendje janë rrahur me shufra gome dhe me mjete tjera, verbalisht janë fyer dhe sharrë në baza etnike dhe fetare, janë qëlluar me shqelma, janë lënë pa ujë dhe pa ushqim, janë lënë pa ndihmë mjekësore dhe janë marrë në pyetje nga pjesëtarë të maskuar të policisë me qëllim që të mos shihet identiteti i tyre. Ekspertët ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut vlerësojnë se kjo praktikë, respektivisht bartja e qytetarëve me mjete transportuese policore me trasta të zeza është “specialitet i policisë maqedonase”.

Për këto raste Avokati i popullit i dërgoi raport të detajuar me propozim masa Ministrisë së punëve të brendshme, ku mes tjerash kërkohej edhe përgjegjësi përkatëse për policët të cilët kanë tejkaluar autorizimet, mirëpo për këto mori përgjigje negative. Raportet dhe propozim masat e Avokatit të popullit lidhur me këto raste u përkrahën edhe nga institucionet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në disa raste Avokati i popullit pati konstatuar se gjatë kryerjes së veprimeve, disa policë kanë bërë veprën penale torturë mbi qytetarët dhe për këtë avokati i popullit para prokurorisë publike ka inicuar procedurë për përgjegjësi penale për këta policë. Mirëpo, prokuroria është përgjegjur negativisht në këto kërkesa.

Në Maj të vitit 2004 në Zherovjan, policia duke përdorur arme zjarri bëri vrasjen e dy qytetarëve nga Tetova dhe seriozisht plagosi një person tjetër. Nga hetimet e këtij rasti nuk doli kurrfarë përgjegjësie, përveç disa rekomandime për përmirësimin e punës së policisë. Posaçërisht është brengosëse sjellja e policisë që punon në teren e cila ka kontakte të drejtpërdrejta me qytetarët.

Përgjegjësia dhe Kontrolli mbi policinë

Në Republikën e Maqedonisë, shkeljet e të drejtave të njeriut sanksionohen në Kodin Penal të RM-së, që nënkupton përgjegjësi edhe për pjesëmarrësit e policisë në pajtim me këtë Kod.

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë në kaptinën 15 përmban veprat që janë vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit. Ndër këto vepra hyjnë edhe:

Neni 137 – Shkelja e barabarësisë së qytetarëve;

Neni 138 – Shkelja e të drejtës së përdorimit të gjuhës dhe të alfabetit;

Neni 139 – Detyrimi;

Neni 140 – Privimi jolegal nga liria;
Neni 142 – Torturimi dhe sjelljet tjera të dhunshme, ç'njerëzore dhe poshtëruese;
Neni 143 – Maltretimi gjatë kryerjes së detyrës
Neni 144 – Rrezikimi i sigurisë;
Neni 145 – Shkelja e pacenueshmërinë së shtëpisë;
Neni 146 – Bastisje joligjore e tj.

Në nenin 65 i Ligjit për punët e brendshme shkelje e disiplinës punuese koniderohet:

1. procedimi në kundërshti me rregullat dhe dispozitat e Ministrisë së punëve të brendshme
2. mosdhënia e të dhënave ose dhënia e të dhënave të pasakta, të cilat sipas dispozitave u jepen organeve të autorizuar , organizatave ose qytetarëve;
3. Sjellje e pahijshme ndaj palëve;
4. mosdhënie e ndihmës juridike dhe ndihmës tjetër palës në kuadër të autorizimeve të veta në realizimin e të drejtave ligjore të saja dhe të interesave juridike;
5. shmangie nga kontrolli mjësor me qëllim të përcaktimit të aftësisë punuese;
6. Shmangie nga aftësimi dhe përsosja e obligueshme profesionale;
7. Përfitimi kundërligjor i dobisë personale në lidhje me kryerjen e punës dhe të detyrave;
8. Përdorimi ose mundësimi që persona tjerë të përdor para ose sende tjera me vlerë që punëtorit i janë besuar gjatë kryerjes së punës dhe detyrave;
9. Kryerje e aktiviteteve që është e papërputhshme me obligimet e të punësuarit;
10. Udhëheqje, shprehje dhe përfaqësimi i qëllimeve dhe bindjeve partiake gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave;
11. Kryerje e veprimeve që paraqesin vepër penal e ecila në pajtim me Ligjin për punët e brendshme është pengesë për lidhjen e marrëdhënies së punës në Ministrinë ose kryerje e veprimit që paraqet shkelje më e rëndë e rendit dhe qetësisë.

Gjithashtu, në këtë nen thuhet se: i punësuari përkohësisht mund të largohet nga puna në Ministrinë në rast se kryen shkelje më të rëndë të disiplinës punuese.

Në Nenin 9 të Rregullores për përdorimin e mjeteve të detyrimit dhe të armëve të zjarrit thuhet se personi i autorizuar zyrtar i cili gjatë përdorimit të mjeteve të detyrimit dhe të armëve të zjarrit do ti tejkalojë autorizimet ligjore, do të përgjigjet në pajtim me dispozitat ligjore.

Në Nenin 60 të Kodeksit të Etikës policore thuhet se policia përgjigjet para shtetit, qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre përmes kontrollit të jashtëm të punës së saj.

Neni 62 thekson se kontrolli shtetëror mbi policinë është i ndarë midis pushtetit ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Neni 62 i cili në mënyrë më të detajuar flet për përgjegjësinë e policisë, është i padefinuar dhe i paqartë. Në këtë nen thuhet se:

- “Në drejtim të zhvillimit të marrëdhënieve midis policisë dhe opinionit nevojitet promovimi i mekanizmave të përgjegjësisë, të bazuara mbi komunikimin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë midis pjesëtarëve të policisë dhe opinionit. Pjesëtarët e policisë janë përgjegjës për sjelljet e tyre para qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Në rast të shkeljes së të drejtave Kushtetuese dhe ligjore nga ana e pjesëtarëve të policisë, mund të kërkojnë mbrojtjen e këtyre të drejtave edhe nga Avokati popullor.”

Prej vitit 2003, në Ministrinë e punëve të brendshme është vendosur një mekanizëm i brendshëm i kontrollit të punës së policisë, ky është Sektori i kontrollit të brendshëm dhe i standardeve profesionale puna e të cilit rregullohet me Rregulloren për kryerjen e punëve në sektorin e kontrollit të brendshëm dhe të standardeve profesionale në Ministrinë e punëve të brendshme. Ky sektor bën

hetime në sajë të të dhënave, informacioneve dhe njohurive që me vetëiniciativë ose me kërkesë i dorëzojnë ose prezentojnë të punësuarit në Ministrinë dhe në sajë të parashtresave të qytetarëve, e që kanë të bëjnë me veprimin joligjor dhe joprofesional të të punësuarve në Ministrinë, si dhe me urdhërin e Ministrit.

Nga dispozitat e lartpërmendura mund të konstatohet se në Republikën e Maqedonisë ka mjaft dispozita të cilat e rregullojnë përgjegjësinë për punën në polici. (edhe pse dispozitat për përgjegjësinë që rrjedhin nga aktet e Ministrisë nuk janë janë të qarta dhe precize aq sa duhet).

Nga analizat e bëra në lidhje me përgjegjësinë e policisë lehtë konstatohet se mekanizmat për përgjegjësinë e policisë në Republikën e Maqedonisë funksionojnë pak ose aspak, gjë e cila është njëri prej shkaqeve kryesore që në Republikën e Maqedonisë aq shumë shkelen të drejtat e njeriut nga policia.

Të dhënat tregojnë se shumë rrallë inicohet procedurë për shkak të përcaktimit të përgjegjësive në sajë të obligimit zyrtar. Praktikë të inicimit të procedurave të këtilla nuk ka as në organet e prokurorisë publike as nga ana e personave zyrtar të burgjeve midis të cilëve hyjnë edhe mjekët. Një pjesë e qytetarëve nuk kanë guximin dhe nuk janë të edukuar që ti paraqesin shkeljet e bëra nga policia. Procedurat gjyqësore gjithmonë përfundojnë në dobi të policisë.

Kontrolli i jashtëm, përkatësisht kontrolli nga Avokati i popullit dhe nga sektori civil dhe joqeveritar ballafaqohet me mungesë të bashkëpunimit dhe me mosrespektimin. Kontrolli i brendshëm nuk jep kurrfarë rezultate. Fitohet përshtypja se edhe në periudhën e pluralizmit askush nuk mund ti bëjë policisë.

Rekomandime

1. Edukimi përkatës i qytetarëve për të drejtat e tyre të njeriut dhe inkurajimi i tyre që të paraqesin të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut të bëra nga policia. Me këtë rast Ministria e punëve të brendshme, në bashkëpunim me Organizatat joqeveritare, duhet të përgatit broshura për të drejtat e njeriut që do të jenë në disponim në të gjitha stacionet policore (dhe në të gjitha vendet tjera publike). Gkithashtu, Kodeksi i sjelljes duhet të vendoset në vende që shihen. E tërë kjo duhet të bëhet në mënyrë afirmative – që qytetarët të fitojnë besim në policinë. Qytetarët nuk janë të njohur se roli themelor i policisë është që ti mbrojnë interesat e tyre dhe se ata kanë të drejtë ta dinë emërin dhe identitetin e policit.
2. Përkrahet kyçja e faktorit ndërkombëtar (OSBE, PROXIMA, ICITAP), dhe aktivitetin e tyre në trajnimin e policisë së Maqedonisë në frymën e standardeve ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut. Dhe kjo ka rëndësi të posaçme posaçërisht për policët që punojnë në teren dhe për çdo ditë janë në kontakt me qytetarët.
3. Kontribut më i madh i mediave në paraqitjen e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut, ata duhet të informojnë për të gjitha rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e policisë. Ne duhet ti inkurajojmë mediat në atë se ato luajnë rol pozitiv në mbrojtjen e të drejtave në mënyrë që publikisht do ti prezentojnë. Kjo duhet të shërbejë për ta ngritur vetëdijen publike për shkeljet e bëra nga ana e policisë, e me këtë tu mundësohet institucioneve publike edhe Organizatave joqeveritare dhënien e përkrahjes më të mirë të drejtave të qytetarëve.
4. Aktivizimi dhe përmirësimi i efikasitetit në funksionimin e mekanizmave për përcaktimin e përgjegjësisë së të punësuarve në polici (kontrolli i brendshëm përmes organeve të MPB-së) dhe posaçërisht kontrolli i jashtëm që bëhet nga organet e pushtetit shtetëror dhe organizatat e qytetarëve (OJQ-të), gjykatat, prokuroria publike, obmucmani, komisionet dhe trupat e Parlamentit të RM-së, dhe në ato institucione ku është e kufizuar

liria e lëvizjes. Për shembull, puna e Komisionit të përhershëm anketues për të drejtat e njeriut mund të përkrahet me komunikim dhe

informim për fazat në rastet e caktuara, edhe me ate që anëtarëve të komisionit do tu ndihmohet në përgatitjen dhe ndërmarrjen e çfarëdoqoftë veprimesh.

5. Transparencë dhe bashkëpunim më i madh i policisë me institucionet për mbrojtjen e te drejtave të njeriut në nivel qendror dhe në ate lokal. Në këtë drejtim ne përkrahim si shembull pozitiv puna e grupit këshillëdhënës dhe punues MINOP në bashkëpunim me MPB,OJQ, me zyrën e Ombucmanit, nën patronatin e Komisionariatit të lartë të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Ky grup shfaq një dedikim të lartë ndaj punës së tij. Përpyekje të ngjashme për bashkëpunim duhet të inicohet edhe në degët tjera të MPB në nivel lokal.
6. T'ju qaset rumbullakësimit të kornizës ligjore (sjella e Ligjit nga Parlamenti që do të zëvendësojnë aktet nënligjore që janë në fuqi në këtë moment) për inkorporimin e standardeve dhe procedurave evropiane për përdorimin e mjeteve të detyrimit me forcë dhe të armëve të zjarrit nga ana e policisë. Ky akt do të jetë lëndë e debatit të gjërë publik.

Gjyqësia dhe të drejtat e njeriut

Realizimi i të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë varet nga dy faktorë që mund të përcaktohen si më me ndikesë:

- Cilësia e legjislativës e cila e përshkruan llojin e të drejtave të njeriut dhe mënyrën e realizimit të tyre; dhe
- Organizimi dhe mënyra e funksionimit të institucioneve të sistemit të jurisprudencës para të cilëve drejtohen qytetarët për të realizuar të drejtat dhe liritë e tyre.

Prej aty mënyra e funksionimit të sistemit gjyqësor dhe cilësia e dispozitave juridike që e rregullojnë këtë materie, përfshirë aty edhe implementimin e tyre, janë faktorët kyç që determinojnë nëse dhe në çfarë sasive do të realizohen të drejtat e njeriut në RM. Për këto shkaqe reforma e sistemit të gjyqësisë patjetër duhet të korespondojë me ndryshimet në sistemin e gjyqësisë, si dhe me krijimin e parakushteve organizative, materijale dhe kadrovike për realizimin e suksesëshëm të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të qytetarit të RM-së.

Dobësi të sistemit të gjyqësisë

Funksionimi i Sistemit gjyqësor e me këte edhe realizimi i të drejtave të qytetarëve në RM të përcaktuara në Kushtetutën dhe Ligjet u tregua si joefikas për shumë shkaqe siç janë:

- Mosazhurniteti i gjykatave i gjykatave që rezulton me ngadalësi dhe zvaritje të zbatimit të procedurave;

- zgjidhjet ekzistuese ligjore të ligjeve procesuale (KPP,LPP LPH) si dhe pengesë për realizimin efikas të të drejtave dhe lirive të njeriut;
- Pohime për koruptim në gjyqësi që ende nuk janë dëshmuar duke pasur parasysh faktin se nuk janë zbatuar procedura lidhur me këte dhe edhe nëse ato janë filluar nuk kanë përfunduar me vendime fuqiplote;
- ndikesa politike mbi punën e gjykatave;
- varësi dhe anim në punën e gjykatave;
- Mospasja e mekanizmave materijale (pajisje dhe mjete financiare) për kryerjen cilësore të funksionit gjyqësor;
- Probleme në organizimin e gjykatave, si dhe në organizimin e punës së gjykatave, siç është për shembull kthyerja e rëndomtë e lëndëve nga Gjykatat e apelit për përsëritje të gjykimit në Gjykatat themelore;
- Moszbatimi i konventave ndërkombëtare nënshkruar i të cilave është RM me vështrim të posaçëm mbi aplikimin e standardeve që i përmban Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Komunikimi i pazhvilluar dhe mbyllshmëria e gjykatave për opinionin e këtushëm (Këtu posaçërisht mendohet në mosdhënien e të dhënave për nevoja shkencore dhe profesionale);
- Pengesë në realizimin e të drejtës së qytetarëve për qasje të barabartë deri te drejtësia janë taksat e larta gjyqësore e kështu me rradhë.

Duke i pasur parasysh dobësitë e theksuara më lartë imponohet nevoja për realizimin e reformave në sistemin gjyqësor të cilat duhet të përfshijnë dy segmente që janë njëlloj të rëndësishëm për funksionimin efikas të gjyqësisë, e këto janë: reforma e legjislativës procedurale dhe reforma strukturalo-organizative.

Reforma në legjislativën procedurale

Reforma e legjislativës procedurale që i përmban mjetet themelore për realizimin e funksioneve të organeve gjyqësore do të ketë për qëllim qasjen më të shpejtë për arritjen e drejtësisë dhe realizimin e shpejtë dhe të thjeshtë të të drejtave dhe interesave të qytetarëve, mbrojtje efikase nga kriminaliteti dhe garancione procedurale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nëpër mekanizmat e sistemit gjyqësor.

Përmes ndryshimit të ligjeve procedurale qëllimi kryesor që duhet të arrihet është të sigurohet efikasiteti më i madh në punën e organeve gjyqësore dhe zvogëlimi i numrit të lëndëve në gjykatat. Rritja e efikasitetit të gjykatave përmes zvogëlimit të numrit të lëndëve dhe zvogëlimit të kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore ka ndikues të drejtëpërdrejtë mbi realizimin efikas të të drejtave gjë e cila nga ana tjetër ndikon drejtpërsëdrejti në përfocimin e besimit të qytetarëve në gjykatat dhe mbi rritjen e autoritetit të gjykatave.

Problemi për mosazhurnitetin dhe zvaritjen e procedurave para gjykatave në RM është njëri prej problemeve më të rëndësishme i cili pret ende të zgjidhet për shkak se ai drejtpërdrejtë ndikon mbi realizimin e të drejtave të qytetarëve.

Rekomandime për reforma në legjislativën procedurale

Zgjidhja e këtij problemi përfshin zgjidhjen e lëshimeve në ligjet procedurale posaçërisht në pjesën e zvogëlimit të të drejtave procesuale që pozitën e debitorit më të mirë në raport me atë të kreditorit, mandej në pjesën e dorëzimit e cila

duhet të sigurojë dorëzim të shpejtë dhe efikase madje përmes shërbimeve të veçanta për shpërndarje, të organizuara jashtë gjykatave në formë të servisit publik i cili do të paguhet pas dorëzimit të realizuar.

Mënyra e këtillë e dorëzimit do të kontribuojë që të anët të kenë përfitim, nga njëra anë gjykatat për shkak se do të fitojnë dërgim të shpejtë dhe efikas e me këtë do të shkurtohet kohëzgjatja e procedurave, e nga ana tjetër shërbimi i dërgimit i cili do të stimulohet në masë të mjaftueshme më marjen e shpërblimit/pagesës për dërgimin.

Në këtë kontekst duhet shtuar se nevojitet ndryshimi i në veprimet procesuale për thjeshtësimin e procedurës së dërgimit në drejtim të stimulimit të palëve (posaçërisht në seancën gjyqësore) të informohen vetë për gjendjen e lëndës në të cilën ata kanë interes të caktuar juridik.

Nevojitet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për procedurë ekzekutive i cili duhet të mundësojë realizimin më të shpejtë dhe më efikas të aktvendimit fuqiplotë të sjellur nga gjykata, gjë e cila është qëllimi përfundimtar për shkak të të cilit zbatohet procedura. Këto ndryshime duhet të lëvizin në drejtim të shkurtimeve të kësaj procedure, debitori në procedurën e tanishme ka pozitë të privilegjuar për shkak se ka të drejtë që të drejtojë edhe një procedurë në kuadër të procedurës përmbaruese pas marrjes së akt-vendimit përmbarues gjyqësor, gjë e cila në masë të madhe kontribuon për zgjatjen e procedurës.

Vështrim mbi aplikimin e Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut nga gjykatata vendase në procedimin e tyre

Republika e Maqedonisë ka ratifikuar Konventën Evropiane, dhe si rezultat i këtij akti në pajtim me nenin 98 paragrafi 2 i Kushtetutës ku marrëveshjeve ndërkombëtare u jepet status i burimit për të drejtën vendase, i obligon gjykatat

vendase ti respektojnë standardet të cilat ajo i përshkruan.

Njëri nga këtyre standardeve është “parimi për gjukim në afat racional” (që është e paraparë në nenin 6 paragrafi 1 të KEDNj) që e obligon shtetin tonë si nënshkruese e Konventës t’ua garantojë këtë të drejtë qytetarëve të saj. Ky parim i obligon gjykatat vendase të procedojnë procedura në afat racional, në të kundërtën çdo zvaritje e paarsyeshme e procedurësdo të konsiderohet shkelhe dhe është në kundërshtim me nenin 6 të Konventës.

Nuk do të mund më si arsytim të theksohen: organizimi i keq në sistemin gjyqësor vendas, zgjidhjet joadekuate dhe të vjetëruara, numri i mamjaftueshëm i gjykatësve nëpër gjykata, mungesa e mjeteve materiale e kështu me radhë, por përkundrazi obligimi i Republikës së Maqedonisë me nënshkrimin dhe ratifikimin e Konventës është të krijojë kushte që qytetarët e saj ta shijojnë këtë garanci.

Në këtë kontekst, duhet të përmendet edhe mosaplikimi i “parimit të gjykimit fer” që është përshkruar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parim kyqë i obligon gjykatat në RM ta aplikojnë në zbatimin e procedurave gjyqësore.

Rekomandime për implementimin e KEDNj

Ky parim si i tillë nuk është i paraparë në legjislativën tonë, madje as nga aspekti i inkorporimit të standardeve ndërkombëtare në ligjet tona, gjë e cila është lëshim i llojit të vet, i cili duhet të tejkalohet me inkorporimin e tij në Kushtetutën e mandej të përpunohet edhe në ligjet procedurale.

Në këtë mënyrë gjykatat jo vetëm përmes KEDNj por edhe me legjislativën vendase do të jenë të obliguara drejtpërsëdrejti dhe qartë për detyrimin e tyre për respektimin e këtij parimi, e me këtë do të kontribuojë për zbatimin më të shpejtë dhe më efikas të të drejtave të qytetarëve të cilët kanë kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Kushtetuta e RM aplikoi tre mekanizma për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e këto janë gjykatat e rregullta, Gjykata kushtetuese e RM-së dhe Avokati i popullit.

Në nenin 50 të Kushtetutës është përcaktuar e drejta e qytetarëve që mbrojtjen gjyqësore ta realizojnë para gjykatave të rregullta, ndërsa para Gjykatës Kushtetuese vetëm ato të drejta që në mënyrë decide janë të theksuara në nenin 110 alineja 3.¹ Nga kjo mund të shihet se Gjykata Kushtetuese e RM jep vetëm ingerencë të kufizuar në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore, madje vetëm të atyre që në mënyrë të prerë janë të theksuara në këtë dispozitë, e jo edhe të gjitha liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutën. Në këtë mënyrë “ingerenca ekskluzive” e Gjykatës Kushtetuese është e paraparë edhe në Ligjin për gjykatat në nenin 6 e të cilit qëndron se gjykatat do të japin mbrojtje gjyqësore e të gjitha lirive dhe të drejtave (gjykatat e rregullta nuk i mbrojnë të drejtat si ingerencë të posaçme por përmes zgjidhjes së kontesteve në lëmi të ndryshme juridike) përveç të atyre që janë nën mbrojtjen gjyqësore të Gjykatës kushtetuese.

Kushtetuta nuk duhet ta bëjë këtë dallim, përkatësisht ai nuk duhet të mbrojë vetëm të drejta dhe liri të caktuara, por përkundrazi duhet të sigurojë mbrojtjen e të gjitha të drejtave përmes Gjykatave themelore.

Respekt ndaj Amendamenteve të Kushtetutës, por qytetarët duhet të jenë të autorizuar të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të veta që janë të përshkruara me Kushtetutë, me ate që do të paraqesin aktpadi para Gjykatës Kushtetuese. Për shembull, Kushtetuta Kroate (në nenin 128) përcakton se: qytetarët janë të autorizuar të paraqesin aktpadi kundër vendimeve të organeve shtetërore nëse

¹ Këto janë të drejtat vijuese që janë të numëruara në mënyrë decide në nenin 110 të Kushtetutës së RM-së, për të cilat Gjykata kushtetuese ka të ashtuquajtur “ingerencë ekskluzive”: liria e bindjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, bashkimit dhe veprimit politik, ndalesa e diskriminimit të qytetarëve në sajë të gjinisë, racës, besimit fetar, përkatësisë nacionale, sociale dhe politike.

konsiderojnë se me këto vendime u janë lënduar të drejtat e tyre.

Kushtetuta Kroate nuk specifikon disa liri dhe të drejta të caktuara për të cilat qytetarët mund të paraqesin aktpadi, por kjo dispozitë më shumë ka të bëjë me të gjitha të drejtat e përcaktuara me Kushtetutën e Kroacisë. Në Kushtetutën e Maqedonisë vetëm të drejtat e numëruara në nenin 110 të Kushtetutës mund të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese. Nëse qytetarët kanë të drejtë të japin aktpadi para Gjykatës Kushtetuese kjo do të ishte vetëm një mjet më tepër për hulumtimin e shkeljeve të të drejtave të tyre dhe kjo do të mund ta reduktonte numrin e ankesave para KEDNj¹. Këto janë të drejtat vijuese që janë në mënyrë decide të numëruar në nenin 110 të Kushtetutës së RM-së, për të cilat Gjykata kushtetuese ka të ashtuquajtur “ingerencë ekskluzive”: liria e bindjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, bashkimit dhe veprimit politik, ndalesa e diskriminimit të qytetarëve në sajë të gjinisë, racës, besimit fetar, përkatësisë nacionale, sociale dhe politike.

Përveç kësaj, procedura para Gjykatës Kushtetuese duhet të jetë e përshkruar me sqarime Kushtetuese-juridike, komente (me ligje jo me akte nënligjore siç është rast me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese e cila aktualisht rregullon procedurat para Gjykatës Kushtetuese).

Parashikimi i mbrojtjes së drrjtpërdrejtë kushtetuese juridike vetëm të disa nga liritë dhe të drejtat themelore, duke mos i përfshirë të tjerat, lë qytetarët pa një mbrojtje jashtëzakonisht efikase të të drejtave të tyre subjektive.

Sa i përket “mbrojtjes ekskluzive gjyqësore” sipas së cilës Gjykata Kushtetuese zbaton Kushtetutën e RM-së, nuk përcaktohen:

- kushte dhe mënyra më të përafërta për realizimin e kompetencës së tij për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të qytetarit;
- llojet dhe karakterin e akteve të caktuara kundër të cilave mund të kërkohet kompetenca e këtillë;
- kushtet që duhet të përmbushen që të kërkohet mbrojtja;
- as veprimi juridik e vendimeve të sjellura me të cilat përcaktohet se ekziston shkelje e lirive dhe të drejtave.

Kushtetuta gjithashtu nuk parashikon sjelljen e ligjit kushtetues ose ligj të thjeshtë me të cilin do të ishin rregulluar këto çështje, por heshturazi lejon që ato të jenë të rregulluara me Rregulloren (e cila në kierarkinë e dispozitave radhitet në kategorinë e akteve nënligjore) e Gjykatës Kushtetuese në kuadër të rregullimit të procedurës dhe mënyrës së punës së saj.

Kështu Gjykata duke lëshuar ti përcaktojë të gjitha elementet që përbëjnë esencën e kësaj mbrojtjeje, duke mos lejuar që kjo të bëhet me ligj, lejon që krijimi i fizionomisë së saj përfundimtare të bëhet me akt nënligjor (pa marrë parasysh se ky është akt i Gjykatës kushtetuese i RM-së).

Me këtë cilësia e rregullimit të kësaj materie, e matur sipas kritereve të ndërlydhura me fuqinë juridike të akteve të përgjithshme juridike në kuadër të strukturës kierkarike zbrit dy nivele më poshtë në raport me standardet e vendeve evropiane në të cilat funksionon kjo kompetencë e gjyqësisë kushtetuese.

Propozohet zbatimi i drejtpërdrejtë i nenit 6 të KEDNj, e aty posaçërisht mendohet në parimin e gjykimit fer nga gjykatësit gjatë zbatimit të procedurave gjyqësore.

Imponohet nevoja për edukim të përhershëm të gjykatësve për konsultim më të shpeshtë dhe aplikim të KEDNj dhe thesarit të pasur të praktikës gjyqësore që e ka krijuar Gjykata Evropiane në Strazbur gjatë periudhës së ekzistimit të saj dhe që vazhdimisht e ka zhvilluar duke e përcejllur zhvillimin e nevojshëm dhe rrethanat

në jetën reale të shoqërisë.

Roli i Ombucmanit ende nuk e ka arritur vendin e vet në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Maqedonisë. Përveç se u sjell Ligji i ri për Avokatin e popullit, ende pritet për implementimin e tij si dhe në përforcimin e rolit të tij që ia ka dhënë Kushtetuta dhe Ligji në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Rekomandime për reformë strukturore dhe organizative

Reforma strukturore dhe organizative ka të bëjë me institucionet e sistemit gjyqësor qëllimi i së cilës duhet të jetë vendosja e institucioneve gjyqësore që janë efikase, stabile, të depolitizuara, të pavarura dhe me përgjegjësi, ndërsa brenda në to duhet të bëhen përpjekje drejtë përmirësimit të profesionalitetit, kompetencës, eticitetit të kuadrove dhe ngritjes së imunitetit të tyre ndaj keqpërdorimeve dhe korupcionit.

Këtu posaçërisht duhet theksuar forcimi i pavarësisë së gjyqësisë, të prokurorive, posaçërisht nga ndikimet politike të dy pushteteve tjera, përmes ridefinimit të statusit të gjykatësve përmes ndryshimit të dispozitave që e rregullojnë këtë materie, përkatësisht Ligji për gjykatat në pjesën e procedurës për selcionimin dhe zgjedhjen e gjykatësve, mandej sistemi i përgjegjësisë së tyre, shkarkimi, përparimi në shërbim.

Në këtë kontekst duhet përmendur edhe nevoja e përmirësimit të sistemit të caktimit të gjykatësve, sistemi i rrogave të gjykatësve, sistemi i finansimit të gjykatave posaçërisht në drejtim të ndarjes së mjeteve të mjaftueshme nga buxheti i RM-së si parakusht i rëndësishëm për funksionimin efikas dhe të pavarur të gjykatave.

Sistemi gjyqësor u mundësoi qasje të njejtë për të gjithë qytetarët drejtë drejtësisë përmes zvogëlimit të taksave gjyqësore, prandaj propozohet që ato të paguhen

vetëm një herë e kjo të bëhet në fillim të procedurës e jo disa herë gjatë procedurës së njejtë. taksat e larta gjyqësore i pamundësojnë dhe i dekurajojnë qytetarët e varfër të inicojnë procedura para gjykatave. Në kontekst të kësaj propozohet që më shpesh, atëherë kur për këtë do të ketë bazë të aplikohen edhe dispozitat për “të drejt[si varfërie” për ato qytetarë pozita e të cilave sociale nuk iu mundëson ti realizojnë të drejtat e tyre para organeve gjyqësore.

Përforcimi i rolit të Ombucmanit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kuadër të kompetencave të përshkruara me ligjin. Zgjedhja e kuadrove të depolitizuara cilësore që me sukses do ta kryejnë funksionin e tyre.

Komente plotësuese

Në raport me korupcionin

Shqyrtuam çështjet e rritjes së rrogave të të punësuarve në gjykatat (posaçërisht të gjykatësve), por u vendos se rritja e rrogave, vetvetiu, nuk do të mund të shërbejë për çthurjen e korupcionit.

U përmend se disa qytetarë mund të shfaqin luhajtje për të bërë diçka nëse do të vërenin korupcion në gjyqësi. Kjo mund të jetë në sajë të shpenzimeve që do ti kishin qytetarët (për paraqitjen e rastit dhe nxjerrjes së tij para gjykatës).

Poashtu duhet të mendojmë edhe për mënyra tjera që t'i inkurajojmë qytetarët të informojmë për rastet e korupcionit (gjithashtu edhe gjykatësit të informojnë në rast se do tu ofrohet mitë).

Rekomandime

1. Një nga zgjidhjet mund të jetë që shteti ti mbulojë shpenzimet në këto raste të korupsionit (për qytetarët që do ta paraqisnin).
2. Duhet ti përforcojmë mekanizmat për hulumtimin e pohimeve për korupsion.
3. Duhet të ofrojmë stërvitje dhe edukim për të punësuarit në gjykatat.

Në lidhje me gjyqësinë e pavarur

U shqyrtua çështja se si të kufizohet ndikesa negative e politikës mbi emërimet dhe shkarkimet e gjykatësve?!

Njëri prej propzimeve ishte që gjykatësit të zgjedhen përmes konkurrencës me gjykatësit tjerë. Për shembull: nëse ka vend të lirë pune në Gjykatën në Tetovë, gjykatësit tjerë të intervjuojnë dhe ta zgjedhin kandidatin që do ta plotësojë këtë vend pune. Nuk është e qartë nëse do të ketë komision që do të konvokohet që ti realizojë intervjuimet; poashtu nuk është e qartë kush do të ishte anëtar i këtij komisioni?!

Një pasojë e mundshme negative është ajo që kjo mund të shpiejë kah nepotizmi dhe të bëhet zhvendosje e nivelit të ndikësës negative, nga niveli nacional në ate lokal, përkatësisht nuk do të ketë balans të forcave, kontrollë të autoritetit të gjykatës. Kjo do ta mundësojë korupsionin brenda gjykatës gjatë emërimit të gjykatësve, posaçërisht për ata që janë mes veti miq ose gjykatës që u kanë dhënë mitë atyre që punojnë në gjykatat.

Kjo temë konkrete kërkon elaborim të mëtejshëm.

Anëtarët e grupit punues për të drejtat e njeriut

- z-ti Abdylaqim Ademi - deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë
- z-ti Senad Beqiri - OJQ Milenium
- z-ti Shpend Devaja –avokat për të drejtat e njeriut
- z-ti Iljaz Halimi – deputet në Kuvendin e Republikës së maqedonisë
- z-nja Gjulsefa Kurteshi – aktiviste në sektorin e OJQ-ve
- z-nja Fatmire Lumani – ministria e punës dhe politikës sociale dhe profesore në Univerzitetin e Tetovës
- z-ti Ardit Mehmeti *
- z-nja Marija Mirçevska – asistent më i vjetër, sundimi i drejtësisë – OSBE
- z-nja Mirjana Najçevska – kryetare e Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut
- z-nja Suzana Saliu – zëvendëse e Avokatit të popullit
- z-ti Zlatko Sarev – avokat për të drejtat e njeriut, aktivist në sektorin e OJQ-ve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të romëve
- z-ti Filip Siljanovski – zëvendës kryetar, Unioni i forcave të reja të VMRO-DPMNE-së
- z-ti Zharko Trajanovski – redaktor në revistën për politikë, gjini dhe kulturë

* njëri nga anëtarët e grupit punues e braktisi Maqedoninë në muajin Gusht dhe nuk kishte mundësi të vazhdojë me pjesëmarrje në punimet e grupit. Dëshirojmë që ti falemnderojmë për kontributin e tij.

